



# HULUMTIM EMPIRIK

Tema: Pompat e benzinës në afërsi të vendbanimeve

Ferizaj, Tetor 2011

Hyrje.....	1
Qëllimi, metodologjia dhe teknikat e hulumtimit.....	2
Interpretimi i rezultateve.....	3
Analizë.....	4
Paraqitja grafike e rezultateve.....	5-7
Pyetësori.....	8

## *Hyrje*

---

Në Komunën e Ferizajt pas vitit 1999 operojnë njëzet e pesë (25) pika të shitjes së karburanteve me pakicë (pompa të naftës dhe derivateve të saj) të cilat ndodhen në lagje të ndryshme brenda dhe jashtë qytetit, dhe në afërsi të zonave rurale (rrugë magjistrale). Nga informatat e marra në Komunën e Ferizajt del se 99% e këtyre bizneseve i kanë objektet pa leje ndërtimi dhe se po këto biznese zhvillojnë veprimtarinë e tyre vetëm me Licencë për zhvillim të veprimtarisë të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përkatësisht Zyra për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të sektorit të Naftës në Kosovë.<sup>1</sup>

Këto biznese vazhdojnë të funksionojnë megjithëse nuk posedojnë leje të ndërtimit nga Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit në Komunën e Ferizajt, sepse zyrtarët e kësaj drejtorie kanë deklaruar se në Komunën e Ferizajt nuk lejohet të jepen leje ndërtimi për pompa të benzinës sepse akoma nuk janë hartuar kriteret dhe parametrat ligjor për ndërtimin e një objekti të tillë.

Ne jemi munduar maksimalisht të marrim informacione të sakta në mënyrë që ta trajtojmë në formën më analitike të mundshme këtë problem. Prandaj përveç informacioneve zyrtare ne kemi zhvilluar edhe një anketë me qytetarë për të matur opinionin e tyre lidhur me problemin e lartpërmendur.

---

<sup>1</sup>Qeveria e Kosovës- Ministria e Industrisë dhe Tregëtisë

## *Qëllimi i hulumtimit*

---

INPO ka identifikuar disa pika të karburanteve brenda qytetit<sup>2</sup> të cilat përveç që nuk posedojnë leje ndërtimi janë shumë afër vendbanimeve madje ngjitur me shtëpitë e banimit dhe ka zhvilluar një anketë me qytetarë të cilët banojnë në këto lagje për të parë nëse këta banorë ndihen të shqetësuar dhe të rrezikuar nga këto biznese.

Qëllimi i këtij hulumtimi është vënia në pah e rrezikut të cilin e paraqesin këto pompa të benzinës, e që për mendimin tonë mund edhe ti quajmë “Bomba të kurdisura”. Përmes këtij hulumtimi dhe formave të ndryshme të avokimit si : tryezat, deklaratat dhe konferencat për media, performancat publike etj, ne shpresojmë se do të ndikojmë në institucionet publike që të merren masa adekuate me qëllim të parandalimit të një katastrofe ku jeta e qytetarëve vihet në rrezik.

## *Metodologjia dhe teknikat e hulumtimit*

---

Realizimi i anketimit u bë në mënyrë direkte në kontakt me responentët, përkatësisht qytetarët të zgjedhur me metodën e rastit në lagjet: 12 Qershori, Enver Topalli, Naim Beka, Vëllezërit Gërvalla, Liman Reka dhe Rizah Matoshi. Janë realizuar njëqind (100) anketa, nga njëzetë (20) anketa për lagje nga data 2 Tetor 2011 deri me 7 Tetor 2011. Pyetësorët përmbajnë gjithsej katër (4) pyetje dhe dy pyetje shtesë ajo për grupmoshën dhe gjininë. Anketa përmban pyetje të mbyllura me nga tri (3) opsione.

---

<sup>2</sup> Rruga: 12 Qershori, Enver Topalli, Naim Beka, Vëllezërit Gërvalla dhe Liman Reka, Rizah Matoshi

### *Interpretim i rezultateve*

---

Hulumtimi i zhvilluar nga INPO lidhur me “pompat e benzinës në afërsi të vendbanimeve” nga 100 të anketuarit ka përfshirë 45% femra dhe 55% meshkuj. Të anketuarit i kanë takuar grupmoshave të ndryshme nga ky numër i të anketuarve 40% i takojnë grupmoshës nga 18-30 vjeç, 48% e tyre nga 30-50 vjeç dhe 12% mbi 60 vjeç.

Pyetja e parë e anketës sonë është: a është shqetësim për ju dhe familjen tuaj prania e pikës së karburantit afër shtëpisë? Nga përgjigjet e marra 63% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se janë shumë të shqetësuar lidhur me këtë problem, 30% janë të shqetësuar deri diku ndërsa 7% e tyre nuk janë aspak të shqetësuar megjithëse disa prej këtyre pikave mund të themi se janë gati të ngjitura me shtëpitë e banimit.

Në pyetjen se, a ndihen të rrezikuar qytetarët nga prania e pikës së karburantit 58% e banorëve të anketuar në lagjet ku ndodhen këto pompa të benzinës ndihen shumë të rrezikuar nga prania e këtyre bizneseve, 35% e tyre u deklaruan se ndihen deri diku të rrezikuar dhe 7% nuk ndihen aspak të rrezikuar.

Sa i përket largimit të këtyre pikave të karburantit nga lagjet e qytetit në të cilat ndodhen, 68% e banorëve kanë pranuar së duhet të largohen duke shmangur kështu rrezikun që u kanoset, 10% mendojnë se nuk duhet të largohen ndërsa 22% kanë thënë se nuk e dinë duke lënë të kuptohet se varet nga strukturat komunale një gjë e tillë.

Në pyetjen e katërt dhe të fundit të anketës sonë se çfarë mendojnë qytetarët a duhet institucionet të lejojnë vendosjen e pikave të karburantit nëpër vendbanime shumica e të anketuarve pra 68% janë kategorikisht të vendosur se nuk duhet lejuar një gjë e tillë, 10% janë përgjigjur pozitivisht dhe 22% nuk e dinë.

## *Analizë*

---

Pas vitit 1999 jo vetëm në Ferizaj, por përgjithësisht në Kosovë janë hapur një numër i madh i bizneseve të reja të cilat mundohen ti plotësojnë nevojat e konsumatorëve në mënyrën më të mirë të mundshme, ndër këto biznese renditen edhe pikat e karburanteve (pompat e benzinës) të cilat ndodhen kudo në vendin tonë. Ky biznes i ri në tregun kosovar mori hov zhvillimi madje doli jashtë kontrollit të institucioneve si shtetërore ashtu edhe komunale.



Megjithëse Qeveria e Kosovës në vitin 2004 ka aprovuar ligjin për ndërtim, ende nuk ka specifikacione lidhur me ndërtimin e objekteve të pompave të benzinës. Me të njëjtin problem ballafaqohet edhe Komuna e Ferizajt e cila tash e 12 vite nuk ka lëshuar leje ndërtimi për objektet në të cilat zhvillohet kjo lloj veprimtarie, megjithatë në Komunën e Ferizajt operojnë gjithsej 25 pika të karburanteve të cilat veprojnë vetëm me leje për zhvillimin e veprimtarisë të lëshuar nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë.

Vetëm brenda qytetit (lagjeve të banuara), INPO ka identifikuar 10 pompa të benzinës, që gjithashtu nuk kanë leje ndërtimi e për me tepër janë rrezik permanent për banorët e atyre lagjeve, gjithmonë duke u bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 2004/15<sup>3</sup> nën 6 paragrafi 6.1 i cili thotë se: Ndërtesat duhen të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që të parandalojnë shkaktimin ose përhapjen e zjarrit dhe tymit dhe duhet të ndërtohen e projektohen në mënyrë që të parandalojnë përhapjen së zjarrit në ndërtesat fqinje.

INPO ka arritur në përfundim se për të mos rrezikuar banorët e lagjeve ku ndodhen këto biznese, kalimtarët e rastit pra për shkak të sigurisë së qytetarëve të Ferizajt të cilën duhet ta garantojnë institucionet komunale, pikave të karburanteve duhet tu ndërpritet veprimtaria deri në momentin kur këto biznese të plotësojnë kriteret dhe standardet e për zhvillimin e veprimtarisë së tyre.


---

<sup>3</sup> Ligji për Ndërtim- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor




### A është shqetësim për ju dhe familjen tuaj prania e pikës së karburantit afër shtëpisë?

■ Po është shumë shqetësuese ■ Jo aspak ■ Deri diku




### A ndiheni të rrezikuar nga prania e pikës së karburantit?

■ Po shumë ■ Jo aspak ■ Deri diku




### A mendoni se duhet të largohet kjo pikë e karburantit nga lagjja juaj?

Po Jo Nuk e di



### A mendoni se institucionet duhet të lejojnë vendosjen e pikave të karburantit nëpër venbanime

Po duhet lejuar Jo nuk duhet lejuar Nuk e di



*Pyetësori*

---

Mosha: 18 – 30 vjet      30 – 50 vjet      mbi 60 vjet

Gjinia:      F                      M

1. A është shqetësim për ju dhe familjen tuaj prania e pikës së karburantit afër shtëpisë suaj?
  - A) Po është shumë shqetësuese
  - B) Jo aspak
  - C) Deri diku
  
2. A ndjeheni të rrezikuar nga prania e pikës së karburantit?
  - A) Po shumë
  - B) Jo aspak
  - C) Deri diku
  
3. A mendoni se duhet të largohet kjo pikë e karburantit nga lagja juaj?
  - A) PO
  - B) JO
  - C) Nuk e di
  
4. A mendoni se institucionet duhet të lejojnë vendosja e pikave të karburantit nëpër vendbanime?
  - A) Po duhet lejuar
  - B) Jo nuk duhet lejuar
  - C) Nuk e di.